



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 10812022

Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. 3110122

Date/Datum/Date:



**PRISHTINË/PRIŠTINA PRISTINA  
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 31 janar 2022

Z. Albin Kurti, Kryeministër  
Qeveria e Republikës së Kosovës  
Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Terezë"  
10000 Prishtinë

**Ex officio nr. 40/2022**

**Opinion i Avokatit të Popullit përkitazi me arsyeshmërinë masave të marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Vendimit nr. 01/55 të datës 21 janar 2022 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, në raport me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut**

Prishtinë, më 31 janar 2022

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, nxori Vendimin nr. 01/55, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës. Qeveria miratoi masa, të cilat në aspektin e politikave kufitare e kufizojnë/pamundësojnë hyrjen në territorin e Kosovës për ata persona të cilët nuk kanë dëshmi për tri doza të vaksinës kundër COVID-19, ose së paku nuk kanë dy doza dhe test PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë para nisjes.

Qëllim i këtij Opinionit është të analizoj arsyeshmërinë e masave të marra nga Qeveria e Kosovës me Vendimin nr. 01/55, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës në raport me kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky opinion nuk duhet kuptuar si kontestim i vullnetit të mirë, si kontestim i synimit të Qeverisë për të mbrojt shëndetin publik në Kosovë, apo kontestim i vlerësimit të ekspertëve shëndetësor. Por, shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, kufizimet e vendosura deri në këtë masë duket sikur janë të ashpra, jo proporcionale dhe si të tilla pa dyshim që ndikojnë në të drejtat e njeriut. Këto masa të aplikuara tani nga Qeveria janë më të ashpra, krahasuar me masat që kanë aplikuar vendet tjera në rajon e që për nga shkalla e infektimeve me virus nuk qëndrojnë më mirë se sa vendi ynë.

#### Vendimi i Qeverisë nr. 01/55, i datës 21 janar 2022

Dy pikat më të diskutuara të masave që u aplikuan me këtë vendim të Qeverisë ishin pika B. dhe pika D. që kanë të bëjnë me hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës dhe kufizimi i qarkullimit:

##### **B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës]**

2. Çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës duhet të posedojë një nga dëshmitë e mëposhtme:

2.1 Certifikatën e vaksinimit me tri (3) doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen dhe dozë përforcuese) kundër COVID-19;

2.2 Certifikatën e vaksinimit me dy doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen) kundër COVID-19, bashkë me testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore)

3. Nga kërkesa për të poseduar ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.2 lirohen:

3.1 Personat të cilët hyjnë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohen nga Kosova (tranzit) brenda tre (3) orësh përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojojë Kosovën brenda tre (3) orësh dhe që dalja në pikë kufitare të jetë e ndryshme nga hyrja kufitare;

3.2 Personat, të cilët punojnë si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga COVID-19;

3.3 Shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë dalë jashtë Kosovës në 12 orët e fundit;

3.4 Qytetarët e huaj, të cilët kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtarë, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda pesë (5) orësh;

3.5 Diplomatët e huaj, të akredituar në Kosovë dhe pjesëtarët e trupave të KFOR;

3.6 Personat nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare;

3.7 Shtetasit e Republikës së Kosovës që nuk i kanë dy doza të vaksinës janë të detyruar të kryejnë karantinim shtëpiak për një periudhë prej shtatë (7) ditësh që nga hyrja në territorin e Republikës së Kosovës;

3.8 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi. Personat e tillë duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, të administruar jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore).

3.9 Personat nga mosha 12 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë.

[.....]

#### D. [Kufizimi i qarkullimit]

14. Kufizimi i qarkullimit të qytetarëve do të jetë nga ora 22:00 deri në ora 05:00, përvçe:

14.1 Rasteve të natyrës urgjente (për të kërkuar ndihmë mjekësore, blerje të barnave, për të ofruar kujdes ose ndihmë mjekësore, për të shmangur dëmitimin ose për t'i shpëtuar një rreziku lëndimi);

14.2 Qarkullimit për personelin shëndetësor, të sigurisë dhe operatorët që kryejnë punë apo shërbime publike; 14.3 Personelin e ndërrimit të natës të operatorëve ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zinxhirit të furnizimit (përfshire transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të veçantë nga sistemi EDI i Administratës Tatimore të Kosovës;

14.4 Personat të cilët ofrojnë dëshmi se duhet të jenë në aeroport gjatë orarit të kufizimit të qarkullimit, për shkak se kanë për të udhëtuar përmes aeroplavit;

14.5 Personave ndaj të cilët aplikohet leja e veçantë e përkohshme që lëshohet nga Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas pikës 16, për shkak të domosdoshmërisë së qarkullimit gjatë orës policore.

15. Obligohen punëdhënësit të sigurojnë që punëtorët e tyre që i nënshtronhen kufizimit nga pikë 14 të kenë kohë të mjaftueshme për të udhëtuar në banesat e tyre.

16. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme mundet që të lëshojë leje të veçantë, për persona të cilët ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për domosdoshmërinë që kufizimi i qarkullimit të orarit të ju zgjatet përkohësisht.

#### Reagimet për masat e reja të aplikuara nga Qeveria

2. Me hyrjen në fuqi të vendimit dhe fillimin e aplikimit të masave të reja nga autoritetet kufitare, në vendkalimet kufitare të Kosovës me vendet fqinje u shkaktua huti dhe pakënaqësi tek qytetarët që cilët nuk u lejuan të hyjnë në territorin tonë si rezultat i aplikimit të masave të reja.

Më 23 janar 2022, ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, përcollti shqetësimin e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut, që kanë lidhje familjare, biznesore e detyrime të tjera që

i lidhin me Kosovën, e të cilët kjo masë i ka kufizuar ndjeshëm, duke konstatuar se gjendja me pandeminë në vendet tona është gati e njëjtë.<sup>1</sup>

3. Më 24 janar 2022, në media u raportua për një protestë e qytetarëve shqiptarë në pikë kalimin Morinë në kufirin Shqipëri-Kosovë duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës të heqin masën për hyrjen në Kosovë me tri doza të vaksinës me arsyetimin se në Shqipëri doza e tretë u jepet vetëm të moshuarve dhe atyre me sëmundje kronike. Protestuesit ishin ankuar se testi PCR kushton rreth 30 euro dhe nuk kanë mundësi ta paguajnë për të hyrë në Kosovë.<sup>2</sup> Sipas raportimeve protesta e qytetarëve të Kukësit ishte tensionuar dhe protestuesit ishin përplasur edhe me policinë kufitare.<sup>3</sup>

4. Në të njëjtë ditë mediat raportuan lidhur me vendimin në fjalë se pati reagime edhe nga kryetarja e Komunës së Preshevës. Sipas mediave kryetarja deklaroj se vendimi i fundit i Qeverisë së Kosovë për masat anti-Covid ka prekur aspektin e lirisë së lëvizjes dhe aspektin financiar në Kosovë. Sipas saj, një numër i studentëve dhe një numër tjetër personash që punojnë e që ushtrojnë veprimitari ekonomike në Kosovë janë prekur nga këto masa. Një reagim të ngjashëm bëri edhe kryetari i Komunës së Bujanocit.

5. Në të njëjtën ditë Forumi Ekonomik Mbarë Shqiptar ka reaguar pas vendosjes së masave nga ana e Kosovës. Në reagim thuhet se masat e vendosura për hyrjet dhe daljet e qytetarëve në Kosovë vështirësojnë dukshëm lirinë e lëvizjes, pasi një pjesë e madhe e qytetarëve nuk mund ta marrin dozën e tretë duke qenë se nuk ka kaluar kohë mjaftueshëm nga doza e dytë (6 muaj). Më tej në reagim thuhet: “*Masa e marrë nga Qeveria, në kufizimin e orarit për lejimin e aktivitetit të gastronomisë deri në orën 21:00 nuk bënë gjë tjetër veçse rëndon akoma dhe më shumë këtë sektor si dhe ndikon në uljen e volumit të shitjeve duke cënuar rëndë të gjitha bizneset që operojnë me këtë sektor. Referuar Organizatës Botërorë të Tregtisë ku përcakton se, rimëkëmbja do të jetë më e shpejtë, nëse vendet i mbajnë tregjet e hapura, nuk vendosin bariera dhe veprojnë së bashku, faktit konkret ku vendet e mëdha të Evropës si Anglia, Franca, Spanja tashmë po i lehtësojnë masat kufizuese në vendet e tyre si dhe rekomandimit të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë ku shprehet qartë se ndalimet ndërkontaktore të udhëtimit duhet të lehtësohen ose të hiqen krejtësisht, ky vendim i Qeverisë së Kosovës, në këto kohë, nuk sjell gjë tjetër veçse pengon lirinë e lëvizjes dhe tregtisë së lirë.*”<sup>4</sup>

6. Po ashtu, më 24 janar 2022 Drejtori i Departamentit të Hotelerisë/Gastronomisë në Odën e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës nëpërmjet një interviste ka shprehur pakënaqësitë e bizneseve në lidhje me masat aktuale. Ai theksoi se është shumë problematike kufizimi i hyrjeve të turistëve të jashtëm dhe kërkimi i tre dozave të vaksinimit duke shtuar se kjo politikë po shkakton një dëm të madh tek subjektet hoteliere/turistike për shkak se shumë biznese varen nga turistët e rajonit, veçanërisht në këto ditë dimri.<sup>5</sup>

#### **Qëndrimet e institucioneve ndërkontaktore në rapport me kufizimet në përgjithësi për shkak të pandemisë COVID 19**

Në rastin e COVID-19 personat e vaksinuar mund të jenë individualisht të mbrojtur nga format e rënda të komplikimeve të COVID-19, por ata nuk janë imun në kuptim të përhapjes

<sup>1</sup><https://telegrafi.com/bekim-sali-kerkova-qe-kosova-te-rishqyrtoje-masat-e-vendosura/>

<sup>2</sup><https://www.albinfo.ch/shqiptaret-nga-shqiperia-me-kerkesa-te-qarta-ndaj-kosoves-hiqni-masen-per-hyrje-me-.tri-doza-te-vaksines/>

<sup>3</sup><https://dosja.al/protesta-blllokohet-rruga-ne-kufi-me-kosoven-qytetaret-perplasen-me-policine/>

<sup>4</sup><https://dosja.al/masat-anti-covid-ne-kufi-femsh-kosoves-po-pengono-qarkullimin-e-qytetareve/>

<sup>5</sup><https://www.facebook.com/ohtks/>

së virusit, prandaj sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë të gjithë personat e vaksinuar dhe ata të pavaksinuar duhet të mbajnë distancë sociale, të bartin maska duke mbuluar hundën dhe gojën si dhe të respektojnë masat higjienike (larjen dhe dezinfektimin e duarve).

7. Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian miratoi rekomandimet me të cilat kërkon nga shtet anëtare të rishikojnë masat që ndikojnë në lëvizjen e lirë të qytetarëve, tani duke u bazuar në situatën individuale të personave dhe jo më në rajonin e origjinës së tyre.<sup>6</sup> Në rekomandime theksohet se udhëtarët që posedojnë një certifikatë të vlefshme digitale të BE-së për COVID-19 nuk duhet t'i nënshtrohen kufizimeve shtesë për lëvizjen e lirë. Një certifikatë e vlefshme digitale e BE-së për COVID përfshin një certifikatë vaksinimi për një vaksinë të miratuar në nivel evropian nëse kanë kaluar të paktën 14 ditë dhe jo më shumë se 270 ditë nga doza e fundit e serisë së vaksinimit parësor ose nëse personi ka marrë një dozë përforcuese. Shtetet anëtare të BE-së mund të pranojnë gjithashtu certifikata vaksinimi për vaksinat e miratuara nga autoritetet kombëtare ose nga OBSh-ja. Një rezultat negativ i testit PCR i marrë jo më shumë se 72 orë para udhëtimit ose një test i shpejtë antigen negativ i marrë jo më shumë se 24 orë para udhëtimit. Një certifikatë rikuperimi që tregon se nuk kanë kaluar më shumë se 180 ditë nga data e rezultatit të parë pozitiv të testit. Personave që nuk posedojnë një certifikatë digitale të BE-së për COVID-19, mund t'iu kërkohet t'i nënshtrohen një testi përpara ose jo më vonë se 24 orë pas mbërritjes. Udhëtarët me një funksion ose nevojë thelbësore, udhëtarët ndërkufitarë dhe fëmijët nën 12 vjeç duhet të përashtohen nga këto kërkesa.

8. Organizata Botërore e Shëndetësisë nëpërmjet deklaratës për takimin e dhjetë të Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) Komiteti i Emergjencës në lidhje me pandeminë COVID-19<sup>7</sup> i mbajtur më 13 janar 2022 në Gjenevë, nxjerr edhe rekomandimet e përkohshme për shtetet palë. Komiteti identifikoi veprimet si kritike për të gjitha vendet. Në rekomandimin 7. kërkohet: “..... mos kërkoni dëshmi të vaksinimit kundër COVID-19 për udhëtimet ndërkombëtare si e vetmja rrugë ose kusht që lejon udhëtimet ndërkombëtare duke pasur parasysh aksesin e kufizuar global dhe shpërndarjen e pabarabartë të vaksinave COVID-19. Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë një qasje të bazuar në rrezik për lehtësimin e udhëtimit ndërkombëtar duke hequr ose modifikuar masat, si testimi dhe/ose kërkosat e karantinës, kur është e përshtatshme, në përputhje me udhëzimet e OBSh-së. Dokumenti i pozicionit të përkohshëm: konsiderata në lidhje me vërtetimin e vaksinimit ndaj COVID-19 për udhëtarët ndërkombëtarë; Konsideratat e politikave për zbatimin e një qasjeje të bazuar në rrezik për udhëtimet ndërkombëtare në kontekstin e COVID-19”

9. Këshilli i Evropës, në Dokumentin Informativ SG/Inf (2020) 11, i datës 7 prill 2020: “Respektimi i Demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare COVID-19”, u ofron qeverive një paketë për trajimin e krizës aktuale sanitare të papprecedent dhe masive në mënyrë të tillë që t'i respektojnë vlerat themelore të demokracisë, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut.<sup>8</sup> Në këtë dokument, pos të tjerash, trajtohen edhe e drejta e jetës private, liria e ndërgjegjes, liria e shprehjes, liria e organizimit. Për të drejtën e jetës private dhe për këto liri, theksohet: “Ushtrimi efikas i të gjitha këtyre të drejtave dhe

<sup>6</sup><https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-5400-2022-REV-1/en/pdf>

<sup>7</sup>[https://www.who.int/news-room/item/19-01-2022-statement-on-the-tenth-meeting-of-the-international-health-regulations-\(2005\)-emergency-committee-regarding-the-coronavirus-disease-\(covid-19\)-pandemic](https://www.who.int/news-room/item/19-01-2022-statement-on-the-tenth-meeting-of-the-international-health-regulations-(2005)-emergency-committee-regarding-the-coronavirus-disease-(covid-19)-pandemic)

<sup>8</sup> Këshilli i Evropës, “Dokumenti Informativ SG/Inf(2020) /”, i datës 7 prill 2020, faqe 1, (linku: <https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1d91>)

*lirive të garantuara nga Nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Konventës përbën një standard bazë të shoqërive moderne demokratike. Kufizimi i tyre është i lejueshëm vetëm nëse vendoset me ligj dhe nëse është në raport të drejtë me qëllimin legjitim për të cilin është vendosur ky kufizim, duke përfshirë edhe mbrojtjen e shëndetit. Kufizimet e konsiderueshme të aktiviteteve të zakonshme sociale, duke përfshirë qasjen në vendet publike të adhurimit, organizimet publike dhe ceremonitë e martesave apo funeraleve, mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme në ankesa të argumentuara në kuadrin e parashikimeve të mësipërme. U takon autoritetet e marrin masat që çdo kufizim i tillë, qoftë i bazuar në derogim apo jo, të jetë i përcaktuar qartë me ligj, në përpunhje me garancitë relevante kushtetuese dhe në raport të drejtë me qëllimin për të cilin është marrë.”<sup>9</sup>*

Këshilli i Evropës i ka të qasshme edhe burimet për mbrojtjen e të dhënavë nga COVID-19, ku përfshihen instrumentet relevante si dhe dokumente të tjera që ndërlidhen përmes mbrojtjen e të dhënavë personale gjatë periudhës së pandemisë.

### **Praktikat e vendeve në rreth**

10. Nga data 6 shtator 2021, për të hyrë në Republikën e Shqipërisë në rrugë tokësore, detarë apo ajrore, qytetarët duhet të jenë të pajisur me:<sup>10</sup>

- a) *Pasaportë vaksinimi, ku nga data e vaksinimit të plotë të kenë kaluar të paktën dy javë ose;*
- b) *Test PCR të kryer brenda 72 orëve, apo test antigen i shpejtë i kryer brenda 48 orëve, ose*
- c) *Dokument/provë që vërtetton se e keni kaluar ose jeni shëruar nga COVID-19 i vlefshëm deri në 6 muaj pas shërimit;*

Këto kritere aplikohen edhe për ata udhëtarë që kalojnë tranzit në Shqipëri. Fëmijët deri në moshën 6 vjeç, përjashtohen nga këto kritere. Qytetarët shqiptarë rezidentë në Shqipëri që kthehen dhe nuk kanë një nga dokumentet e sipër përmendura, duhet të vetë izolohen për 10 ditë dhe të informojnë autoritetin shëndetësor për të kryer test në fund të izolimit.

11. Për të hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga 1 shtatori 2021, në vendkalimet kufitarët duhet të posedojnë njërin nga dokumentet vijuese:<sup>11</sup>

- a) *Certifikatë/vërtetim për imunizim të kryer (vaksinim) nga virusi SARS-CoV-2, përkatesisht për marrjen e të paktën dy doza të vaksinës kundër sëmundjes ngjitetës COVID-19;*
- b) *Certifikatë/vërtetim për COVID-19 të kaluar në 45 ditët e fundit, llogaritur nga dita e shërimit;*
- c) *Vërtetim mjekësor me rezultat negativ të testit RT-PCR për SARS-CoV-2, të bërrë 72 orë para hyrjes/daljes në/nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose*
- d) *Rezultat negativ nga testi i shpejtë antigen, të bërrë 48 orë para hyrjes/daljes në/nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

Certifikata/vërtetimi, nuk iu referohet personave nën moshën 18 vjeçare. Shtetasit vendorë ose të huaj, të cilët gjatë hyrjes në vendkalimin kufitar të territorit të Republikës së

<sup>9</sup> Po aty, faqe 6 të dokumentit

<sup>10</sup> <https://punetejashtme.gov.al/sq/informacion-mbi-levizjen-e-shtetasve-te-huaj-ne-shqiperi/>

<sup>11</sup> <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/1706/informacione-p%C3%A9Br-covid19>

Maqedonisë së Veriut nuk do të dorëzojnë njërin nga dokumentet e theksuara në paragrafin 1 alinjet 1, 2, 3 dhe 4 të kësaj pike, në mënyrë të detyrueshme dërgohen në izolim/karantinë shtëpiake në shpenzim vetanak, në kohëzgjatje prej shtatë ditësh, për çka Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor lëshon aktvendim. Izolimi/karantina shtëpiake mund të ndërpritet pas ditës së pestë, vetëm me dorëzim të vërtetimit mjekësor me rezultat negativ të testit RT PCR SARS-CoV-2

12. Nga data 2 janar 2022, hyrja në Mal të Zi lejohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:<sup>12</sup>

- a) *Personi është vaksinuar plotësisht me numrin e caktuar të dozave të vaksinave kundër koronavirusit dhe nga doza e dytë e vaksinës, nuk ka kaluar më shumë se gjashtë muaj;*
- b) *Personi e ka kaluar COVID-19 (kanë kaluar jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë nga testi PCR pozitiv ose testi i shpejtë antigen pozitiv).*
- c) *Në të dyja rastet, personi duhet të ketë edhe një test negativ PCR jo më të vjetër se 72 orë, ose një test të shpejtë antigen negativ jo më të vjetër se 48 orë.*

13. Për kalimin në territorin e Republikës së Kroacisë deri më 31 janar 2022, mbeten në fuqi masat që ndalojnë ose kufizojnë, përkohësisht, kalimin e udhëtarëve përmes pikave të kalimit kufitar të Republikës së Kroacisë, me qëllim për të mbrojtur popullsinë e Republikës së Kroacisë nga pandemia COVID-19.<sup>13</sup> Ky vendim nuk zbatohet për personat që vijnë drejtpërdrejt nga shtetet anëtare të BE-së ose rajone të zonës Shëngjen dhe nga vendet tjera që posedojnë certifikatën digitale COVID-19 të BE-së. Personat që vijnë drejtpërdrejt nga shtetet e BE-së të cilët nuk posedojnë certifikatë digitale të BE-së, do të lejohen përashtimi të hyjnë në Republikën e Kroacisë nëse:

- a) *konfirmim jo më i vjetër se 365 ditë nga marrja e dy dozave të vaksinës së përdorur në shtetet anëtare të BE-së (Pfizer, Moderna, AstaZeneca, Gamaleya, Sinopharm) ose vaksinave të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për përdorim urgjent (Serum Institute of India - Covishield, Bharat Biotech - Covaxin, Sinovac - CoronaVac) ose paraqitje e një certifikate jo më të vjetër se 365 ditë nga marrja e një doze vaksine të marrë në një dozë (Janssen / Johnson & Johnson) nëse kanë kaluar 14 ditë nga marrja e asaj doze;*
- b) *konfirmimi i marrjes së dozës së parë të Pfizer, Moderna ose Gamaleya, me të cilën mund të hyhet në Republikën e Kroacisë në periudhën nga 22 deri në 42 ditë nga marrja e vaksinës, ose nga 22 deri në 84 ditë nga doza e parë e AstraZeneca;*
- c) *konfirmimi i shërimit nga COVID-19 dhe marrja e një doze të vetme vaksine brenda 8 muajve nga fillimi i sëmundjes, me kusht që vaksinimi të kryhet më pak se 12 muaj para mbërritjes në pikën kufitare;*
- d) *prezantimi i një PCR ose testi i shpejtë i antigenit që konfirmon se personi është shëruar nga infekzioni me virusin SARS-CoV-2, i cili test është kryer 365 ditë më parë dhe më i vjetër se 11 ditë nga data e mbërritjes në pikën kufitare ose me certifikatë mjekësore për ta kaluar atë;*

<sup>12</sup><http://www.ambasadat.gov.al/montenegro/sq/ashpersohen-masat-per-hyrje-ne-mal-te-zi>

<sup>13</sup><https://mup.gov.hr/uzg-covid/hrvatski/286211>


- e) ose testimi PCR ose testimi i shpejtë i antigjenit - BAT mbi SARS-CoV-2 menjëherë pas mbërritjes në Republikën e Kroacisë (me shpenzimet e veta), me detyrimin e vet izolimit deri në arritjen e një konstatimi negativ. Në rast të pamundësisë së testimit, caktohet masa e vet izolimit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditësh.

## Përfundim

Nisur nga praktikat e vendeve të rajonit shihet se asnjëra prej tyre nuk kërkon nga qytetarët tri doza të vaksinës. Si rrjedhojë e vendimit të fundit të Qeverisë së Kosovës kishte edhe kundërshtime, reagime dhe protesta (shih paragrafët më lartë). Këto shqetësimë duhet t'i marrë parasysh Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë që të rishikohen masat në këtë drejtim meqenëse gjendja epidemiologjike e Kosovës dhe shteteve për rrëth aktualisht nuk ka ndonjë dallim rrënjosorë. Pjesa dërmuese e shteteve që nga fillimi i pandemisë në hyrje dalje të kufijve të tyre i kanë pranuar testet antigen. Këto teste janë më të shpejta dhe më të përballueshme për xhepin e qytetarëve, por pavarësisht kësaj ato ende nuk po pranohen për hyrje/daljet në pika kufitare të Kosovës, por qytetarëve i'u kërkohet testi RT-PCR, i cili është dyfish më i shtrenjtë dhe merr më gjatë kohë për tu përpunuar në laborator.

E konsideroj të nevojshme që Qeveria të rishqyrtoj edhe masën e kufizimit të qarkullimit nga ora 22:00 deri në 05:00. Në vend të kësaj do të ishte më e dobishme që të fuqizohen mekanizmat e kontrollit sanitari dhe inspektoratet në mënyrë që të ushtrohen kontolle të rrepta për të vlerësuar nëse janë duke u zbatuar masat e përgjithshme, tanimë të ditura.

Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i kushtoi kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël apo deri në atë masë sa është e domosdoshme për arritjen e qëllimit legjitim, masa këto që të konsiderohen si të nevojshme në një shoqëri të hapur dhe demokratike.

  
Me nderime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

Kopje për: Z. Rifat Latifi, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë